



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SHITES
MUNICIPALITY OF SHITIM/ OPSTINA SHITIMJE



Zyra e Kryetarit të Komunës

/Kancelarija presednika opstine/mayor's office

Zyra për Informim/ Information Office/ Kancelarija za Informisanje

Nr. i Protokollit:02/780

Procesverbal për raportin gjashtëmuor të kryetarit të komunës për punën e ekzekutivit të komunës së Shites për periudhën janar-qershor 2026, dhe dëgjimit buxhetor për Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029 mbajtur më 19.06.2026

(Me qytetarët e Komunës së Shites)

E mërkurë, më 19.06.2026

Kohëzgjatja e takimit: 15:00 - 17:00

Vendi i takimit: Salla e Kuvendit Komunal

Në mbledhje morën pjesë: Nënkryetari i Komunës Adnan Ademi, Drejtori për Buxhet dhe Financa Besnik Ahmeti, Asambleistë të Kuvendit dhe qytetarët.

Dëgjimin publik e hapi Gentiana Mehmeti nga zyra e kryetarit, e cila prezantoi rrjedhën e takimit.

Rendi i ditës:

-Takimi i parë publik me qytetarë mbi raportin e punës gjatë periudhës gjashtëmuore (Janar-Qershor 2026) të Ekzekutivit të Komunës së Shites nga kryetari dr. Qemajl Aliu

-Korniza Afatmesme Buxhetore 2027-2029

Adnan Ademi: Faleminderit që keni gjetur kohë të vini në këtë takim të prezantimit të raportit gjashtëmujor të Ekzekutivit për Periudhën Janar-Qershor 2026 dhe konsultimit buxhetor KAB 2027-2029, që të paraqisni shqetësimet dhe kërkesat e tuaja, të cilat ne do t'i dëgjojmë dhe sipas mundësisë dhe rëndësisë do t'i fusim në kornizën afatmesme buxhetore 2027-2029.

Po vazhdojmë pa humbur kohë me prezantim e raportit të kryetarit, ku kjo periudhë është karakterizuar me angazhim të vazhdueshëm në realizimin e projekteve zhvillimore, investimeve kapitale dhe përmirësimin e shërbimeve për qytetarët. Fokus i veçantë i ekzekutivit ka qenë zbatimi i projekteve të planifikuara, sigurimi i investimeve të reja dhe bashkëpunimi me institucionet qendrore dhe partnerët ndërkombëtarë.

Në kuadër të investimeve kapitale, punimet po vazhdojnë me intensitet të lartë në disa prej projekteve më të rëndësishme të komunës.

Objekti i ri i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, me sipërfaqe prej rreth 3,000 metra katrorë, ka përfunduar fazën e ndërtimit të vrazhdë dhe pritet të vazhdohet me fazat e tjera të realizimit. Gjithashtu, mbi 50 për qind e punimeve janë realizuar në objektin e Entit Special, ndërsa ndërtimi i objektit të ri të Komunës ka arritur rreth 90 për qind të realizimit, duke dëshmuar përkushtimin tonë në krijimin e infrastrukturës moderne institucionale.

Punimet në Tregun e Gjellbër janë në fazën përfundimtare, ndërsa projekti për rregullimin e lumit 'Shtimjanja' po zhvillohet sipas planit në të gjitha segmentet e shtratit të lumit.

Një rëndësi të veçantë i kemi kushtuar edhe projekteve memoriale. Investimi mbi 400 mijë euro për rregullimin e Varrezave të Dëshmorëve është drejt përfundimit dhe shumë shpejt pritet përrurimi i tij, ndërsa është planifikuar edhe faza e dytë, e cila do të përfshijë rregullimin e Varrezave të Veteranëve.

Në sektorin e arsimit dhe kujdesit për fëmijët po vazhdojnë punimet për ndërtimin e çerdhes dhe aneksit të shkollës në Petrovë. Një projekt me rëndësi të veçantë është edhe garantimi i furnizimit me ujë të pijshëm për Pjetërshticën. Ky investim prej 400 mijë eurosh përfshin ndërtimin e 12 kilometrave rrjet primar dhe kyçjen e çdo shtëpie në sistemin e ujësjellësit, duke siguruar mbulueshmëri të plotë dhe furnizim cilësor me ujë të pijshëm.

Gjatë kësaj periudhe kemi përruruar edhe investimet në kuadër të projektit të eficiencës energjetike në tri shkolla të komunës. Me një investim prej mbi 862 mijë eurosh janë realizuar termoizolimi i objekteve, ndërrimi i dritareve dhe dyerve të jashtme, vendosja e ndriçimit LED, instalimi i pompave termike dhe renovimi i sistemit të ngrohjes, duke përmirësuar ndjeshëm kushtet për nxënësit dhe stafin arsimor. Po ashtu, në bashkëpunim me KFOR-in turk është realizuar renovimi i shkollës 'Bajram Curri' në Mollopolc, ku janë rregulluar nyjet sanitare, salla e arsimtarëve, banjot, janë lyer muret dhe janë vendosur dyer të reja.

Një tjetër projekt i rëndësishëm është funksionalizimi i Qendrës Rinore, e cila është restauruar dhe pajisur plotësisht me inventar të ri, ndërsa është përruruar edhe rruga 'Hysiqi', investim prej 350 mijë eurosh, i realizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës, duke përmirësuar qarkullimin dhe lidhjen e kësaj zone me pjesën tjetër të qytetit.

Po ashtu, kemi nisur realizimin e disa projekteve të reja zhvillimore, ndër to ndërtimin e dy fushave të tenisit në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, fillimin e punimeve në rrugën Rancë–Greiçec, adaptimin e çerdhes në Carralevë, e cila do t'u shërbejë fëmijëve të Carralevës, Pjetërshiticës, Belincit dhe Zborcit, si dhe ndërtimin e aneksit të rrugës kryesore të Topillës, me gjatësi mbi katër kilometra.

Në fushën e zhvillimit ekonomik kemi vazhduar mbështetjen për bizneset e vogla. Njëmbëdhjetë biznese kanë përfituar nga programi 'In Motion', në bashkëpunim me UNDP-në, duke u mbështetur me trajnime profesionale, pajisje, këshillim dhe ngritje të kapaciteteve për zhvillimin e tyre. Ndërkohë, në sektorin e bujqësisë, në bashkëpunim me IADK-në, janë ndarë mbi 41 mijë euro grante për fermerët dhe përpunuesit e ushqimit, ndërsa 20 përfitues janë mbështetur me sera dhe pajisje për përpunimin e produkteve bujqësore.

Përmirësimi i hapësirave publike ka qenë një tjetër prioritet. Janë ndërtuar katër parqe të reja në Gllavicë, Lagjen e Pajtimit, Vojnovc dhe Mollopolc, ndërsa janë realizuar trotuare dhe shtigje të reja për këmbësorë në Petrovë, Lagjen e Tërshanëve dhe Gjyrkoc. Njëkohësisht po vazhdon ndërtimi i katër sallave sportive në Godanc, Reçak, Zborc dhe Rashincë, investime që do të krijojnë kushte shumë më të mira për zhvillimin e sportit dhe aktiviteteve rinore.

Në sektorin e arsimit kemi rritur ndjeshëm mbështetjen për studentët, duke e rritur numrin e bursistëve nga 24 në 120.

Po ashtu, janë ndarë 100 mijë euro për mbështetjen e organizatave kulturore, rinore dhe klubeve sportive, me qëllim fuqizimin e jetës kulturore dhe sportive në komunën tonë.

Në aspektin social kemi vazhduar mbështetjen për kategoritë në nevojë. Gjatë kësaj periudhe janë mbështetur financiarisht 171 lehona, ndërsa ndihmë kanë përfituar edhe 58 persona me sëmundje të rënda.

Përveç investimeve, gjatë kësaj periudhe janë organizuar edhe një sërë aktiviteteve kulturore, artistike dhe përkujtimore, ndër të cilat koncerti recital i sopranos Erblina Rexhaj, gara 'MX Vjosa Race', promovimi i librit 'Ju flet Tirana', aktivitetet për Ditën e Fëmijëve, shfaqja 'Komedi në Kështjellë', ekspozita kushtuar Çamërisë, Akademia Përkujtimore për 5 Majin në Ditën e Dëshmorëve të Kombit, ceremonia e parë madhështore për maturantët e komunës, si dhe koncerti solemn për 12 Qershorin në Ditën e Çlirimit të Shtimes.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe kemi mirëpritur personalitete të njohura të jetës kulturore dhe kombëtare, ambasadorë të shteteve mike dhe kemi zhvilluar takime të rëndësishme me ministra të Qeverisë së Republikës së Kosovës për realizimin e projekteve të reja zhvillimore në komunën tonë. Janë zhvilluar edhe takime për projekte strategjike, si mundësia e ndërtimit të Qendrës Nacionale të Hendbollit në Shtime dhe investimet në sektorin energjetik.

Në fund të këtij prezantimi ju them se Komuna e Shtimes ka vazhduar të përfaqësohet denjësisht edhe në ngjarje kombëtare dhe ndërkombëtare, duke promovuar potencialin zhvillimor të komunës dhe duke krijuar partneritete të reja për investime dhe bashkëpunim institucional. Besoj se rezultatet e arritura gjatë gjashtëmujorit të parë janë dëshmi e punës së përbashkët dhe e

përkushtimit të institucioneve komunale për të ofruar zhvillim, shërbime cilësore dhe një jetë më të mirë për të gjithë qytetarët e Komunës së Shtimes."

Kaq kisha për raportin e kryetarit, tani do të vazhdoj edhe me prezantim e Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029, e më pas mirëpres, pyetjet, kërkesat por edhe sygjërimet e juaja.

Me miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore, tani po e nisim procesin e planifikimit të buxhetit për vitin 2027. Ajo që do të përfshihet në këtë buxhet do të vendoset së bashku me ju, përmes dëgjimeve publike dhe diskutimeve të hapura. Edhe në vitet e kaluara, gjatë dëgjimeve publike nëpër fshatra, prioritetet e qytetarëve i kemi trajtuar me seriozitet dhe jemi përpjekur t'i përfshijmë në buxhet. Të njëjtën qasje do ta ndjekim edhe në këtë mandat, duke i dhënë përparësi kërkesave dhe nevojave të qytetarëve. Si qeverisje, kemi pasur sfida financiare për shkak të obligimeve që rrjedhin nga kontrata kolektive dhe kontrata të tjera, si dhe borxheve të trashëguara. Megjithatë, jemi munduar t'i menaxhojmë ato me përgjegjësi dhe do të vazhdojmë ta bëjmë të njëjtën gjë edhe këtë vit.

Buxheti i Komunës së Shtimes për vitin 2027 pritet të jetë rreth 12 milionë euro, i ndarë në kategori të ndryshme buxhetore. Sot, megjithatë, fokusi ynë kryesor është diskutimi për investimet kapitale dhe përcaktimi i prioritetëve që do t'i shërbejnë zhvillimit të komunës.

Ju e dini se gjatë katër viteve të fundit kemi rritur vazhdimisht subvencionet dhe mund të them me përgjegjësi të plotë se kemi arritur nivelin maksimal të mundshëm. Pavarësisht kësaj, zotohem se çdo kërkesë që vjen nga qytetarët, subjektet politike apo anëtarët e Kuvendit Komunal do ta shqyrtojmë me seriozitet, do ta prioritetizojmë dhe, në përputhje me mundësitë buxhetore, do të përpiqemi ta përfshijmë në buxhet.

Tani të nderuar të pranishëm fjala është për ju dhe mirëpresim, kërkesat, vërtetjet e sygjërimet. Edhe njëherë ju falenderoj për pjesëmarrjen.

Shëfqet Krasniqi: Përsëndetje për të gjithëve! Unë kam dy pyetje, apo më mirë të them dy hamendësime. Sa i përket lumit, besoj se në vërshimet e para do të ketë probleme për shkak të ngushtimit të shtratit. Ndërsa sa i përket çerdhes në Carralevë, mendoj se nuk është dashur të ndërtohet një aneks, por një objekt i ri, për shkak të zhurmës që krijohet në shkollë, kur dihet se çfarë kushtesh kërkon procesi edukativ për fëmijët e vegjël.

Adnan Ademi: Sa i përket çështjes së lumit, projekti është hartuar nga ekspertët dhe funksionaliteti i tij është dëshmuar edhe gjatë reshjeve të muajve të fundit, kur shumë qytete dhe fshatra u përballën me vërshime, ndërsa lumi "Shtimjanja" nuk shkaktoi vërshime të mëdha. Gjithashtu, dua t'ju informoj se aktualisht në projekt janë të angazhuara tri kompani të ndryshme, të cilat po punojnë paralelisht në segmente të ndryshme të lumit.

Sa i përket çerdhes në Carralevë, edhe ai projekt është hartuar nga ekspertët dhe konsideroj se shqetësimet e ngritura do të adresohen, ndërsa projekti do t'i plotësojë kushtet e nevojshme për funksionim.

Demokrat Mujota: Është shqetësim i të gjithëve. Na keni premtuar Planin Zhvillimor Komunal. Ku jemi me këtë plan, pasi ende nuk e kemi?

Basri Rexhaj: Unë e shoh që Shtimja po ecën me hapa shumë të mëdhenj dhe po realizohen punë që nuk janë bërë asnjëherë më parë. Në Petrovë kemi votuar Vetëvendosjen, por kemi vetëm një deputet që na përfaqëson. Punët që janë bërë në Petrovë janë realizuar nga ekzekutivi, duke pasur parasysh edhe numrin e banorëve të këtij fshati. Megjithatë, ka ende shumë për t'u përmirësuar. Do të kërkoja ndërtimin e një fushe moderne sportive te Kodra e Mullinit, si dhe ndërtimin e rrugës deri te fusha, pasi ajo zonë ka potencial të madh dhe ndodhet në një pjesë piktoreske.

Beqir Ahmeti: Kam disa kërkesa për fshatin Godanc, edhe si prind i një fëmije me nevoja të veçanta. Ju përgëzoj për punët që keni bërë. Është punuar mirë, por ka ende ka nevojë për investime. Kanë mbetur tri rrugë pa u asfaltuar: rruga te xhamia në pjesën e sipërme të fshatit, rruga te Halimi dhe aneksi i rrugës Topillë, ku e kam edhe serrën time. Në atë pjesë mungon ndriçimi dhe ka dalje në rrugën kryesore. Gjithashtu, te objekti i shoqatës së personave me aftësi të kufizuara kemi bërë kërkesë për rregullimin e objektit, në mënyrë që të krijohen kushte më të mira për këta persona. Po ashtu, kërkoj ndërtimin e një ure te "Besimi Commerce", ku janë të vendosura bizneset, pasi në atë pjesë ka vërshime të shpeshta për shkak të kanalit kullues.

Ismet Sadiku: Unë jam punëtor i arsimit. Kam kërkesë për shkollën e fshatit Zborc, për rregullimin e sallës së edukatës fizike, si dhe renovimin e shkollës, përfshirë muret, tualetet dhe klasat. Po ashtu, kërkoj rregullimin e trotuarit në Lagjen e Gjicëve. Sa i përket çerdhes në Carralevë, si pedagog konsideroj se nuk është aspak problem dhe se objekti i plotëson kushtet e nevojshme.

Nexhmedin Sylja: Shumë pak po përmendet Reçaku. Ka nevojë të rregullohet ura, e njohur si ura e Ramadan Hysenit, të zgjidhet kanalizimi i shkollës dhe të ndërtohet një park. Pyetja ime kryesore është: kur do të fillojnë punimet në kompleks?

Naim Zejna: Unë vij këtu si përfaqësues i Lagjes "Komandant Kumanova". Dua të ndërlidhem me projektin e lumit "Shtimjanja". Te ura e vjetër, siç e quajmë ne, është bërë një projekt shumë i mirë. Kërkesa ime është që edhe ai segment i lumit, te ura, të përfshihet në projekt. Gjithashtu, të zvogëlohet harku i urës, pasi e rëndon konstrukcionin dhe pengon pamjen.

Fatlinda Rrafshi: Kam një kërkesë nga banorët e fshatit Petrovë për rregullimin e ndriçimit në rrugën e qytetit.

Idriz Neziraj: Përshëndetje. Kam kërkesë për ndërtimin e kanalizimit në rrugën "Komandant Kumanova", afër Liqenit të Mjellmave, si dhe për sigurimin e transportit për nxënësit.

Sabri Krasniqi: Përshëndetje. Me gjithë punët e mira që po bëhen, ende ka nevojë për investime. Sa i përket fshatit Dugë, problemi kryesor që duhet të zgjidhet me prioritet është emërtimi i rrugëve. Shumë banorë dëshirojnë të kthehen dhe të investojnë në agroturizëm, por vizitorët nuk kanë mundësi t'i gjejnë adresat, pasi rrugët nuk kanë emra dhe nuk figurojnë askund. Gjithashtu, në projektin e ujësjellësit për Pjetërshticën do të ishte mirë të përfshiheshin edhe Dugë dhe

Karaçica. Te kroni në Dugë, që është një shenjë e trashëguar nga të parët tanë, kërkoj vendosjen e tri dritave.

Fatmir Misini: Përshëndetje. Kam kërkesë që në Lagjen e Pajtimit, në rrugën "Çamëria", të asfaltohet rrugica e parë, ndërsa në pjesën ku ka qenë ferma të rregullohet kanalizimi.

Qamil Krasniqi: Përshëndetje. Jam nga Karaçica. Banorët kanë filluar të kthehen, gjë që është me rëndësi edhe për komunën. Kam kërkesë për asfaltimin e disa rrugicave, përmirësimin e rrjetit elektrik, pasi furnizimi me energji është shumë i dobët, asfaltimin e tri rrugëve në Lagjen Kelmendi, të dy segmenteve në rrugën Krasniqi, si dhe shtrimin me zhavorr të disa rrugëve të tjera.

Haqif Arifi: Unë kam vetëm një pyetje: A do të publikohen të gjitha projektet, operatorët ekonomikë dhe vlerat e projekteve?




Ezona Selmani: Përshëndetje të gjithëve. Kam kërkesë që të vendoset ndriçimi në Lagjen e qytetit, pasi frekuentohet shumë nga banorët. Gjithashtu, kërkoj të zgjerohet rruga te pjesa e urës në rrugën "Mejdi Korani" ose, së paku, të vendoset sinjalizim adekuat, pasi ajo pjesë është shumë e rrezikshme.







Procesmbajtëse: Vlora Hyseni



**Lista e pjesëmarrësve në takimin e parë publik për këtë vit me Kryetarin e
Komunës, Dr. Qemajl Aliu**

Shtime, 19.6.2026 (e premte)

Nr.	Emri dhe mbiemri	Institucioni	Nënshkrimi
1.	Gyzena Selmani		
2.	Fatinda Rrafshi	KKSH	
3.	Admire Selmani	Zyra Informimit	
4.	Gresa Bidimi		
5.	Teuta Mustafa	Zyra për Informim	T. Mustafa
6.	BESMIR REXHAT		BREXIRAT
7.	BASRI REXHAT		B Rexhat
8.	Muhamet Qami		
9.	SALIH BASHIRAMI		
10.	Albana Ramadani	K.K	ARamadani
11.	Sebr Krasniqi		
12.	Flamar Mudini		F. M
13.	Qamil Krasniqi	Keragice	
14.	Bolli Hozin		
15.	Beqir Ahmeti	Godome	
16.	Agim Ahmeti	Godome	
17.	Dejir Kosiraj	SHLime	

18.	Blendina Qomdli	BT	
19.	Skender Xhuti	Komunistike	
20.	ADEN QAKADAKI	Q.P.S.	
21.	ILAZ KADRIJA	QAKMFI	Altazi
22.	DRITON LATIFI	F.SH.GODANEC	
23.	Albion Shabani	K.Shtime	ASH
24.	Bashkim Pusthi	DREJTOR	
25.	SANITE SADIKI	DREJTORESHE	
26.	Valon Zonura	DREJTOR	
27.	Hail Kurtan	Drejtor	
28.	Ismet Gzoliku	Pedagog	
29.	Naim Ljini	Pr. K. Komonovo	
30.	Hogji Anfi	K.Komunal	
31.	Erza Salija	Kuvendi Komunal	
32.	Shefqet Krasniqi	K. Komunal.	
33.	Demokrat Mujeta	K. Komunal.	
34.			
35.			
36.			
37.			
38.			
39.			
40.			